

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-225/15

**Prishtinë,
30 Maj 2018**

Në çështjen juridike të:

R.L.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit i AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Ragip Namani, anëtarë, duke vendosur rreth ankesës kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA43160), të datës 18 qershor 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 30 Maj 2018, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e R.L. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014, të datës 18 qershor 2014, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA43160.
2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014, i datës 18 qershor 2014, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA43160.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 21 gusht 2007, R. L. (më tej: pala ankuese) ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) në emër të J. L. (gjyshit të tij të ndjerë), duke kërkuar konfirmimin e të drejtës së pronësisë dhe ri-posedimin e ngastrës kadastrale me numër 9/92, një mal i klasit 5 me sipërfaqe prej 00.25.00 ha, që ndodhet në fshatin Movljanje-Komuna e Suharekës (më tej: prona e kërkuar).
2. Ai pretendoi se gjyshi i tij i ndjerë është pronar i pronës së cekur e cila është e uzurpuar nga persona të panjohur. Sipas tij, humbja e posedimit kishte ndodhur më 11 qershor 1999 për shkak të rrethanave të viteve 1998-99. Përveç konfirmimit të së drejtës së pronësisë dhe ri-posedimit, pala ankuese kërkon kompensim për kohën gjatë së cilës nuk ka mundur ta shfrytëzonte pronën e kërkuar.
3. Për ta mbështetur kërkesën e tij, pala ankuese në AKP i dorëzoi këto dokumente:
 - Fletën Poseduese nr.81, të lëshuar më 14 nëntor 1961, nga Komuna Kadastrale e Suharekës, ku prona e kërkuar evidentohet në emër të J. L,
 - Çertifikatën e lindjes nr.200 në emër të palës ankuese, të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil të Komunës së Suharekës më 11 janar 1979,
 - Çertifikatën e vdekjes nr.73 të N.L. (babai i palës ankuese) të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil të Komunës Lapovo më 8 tetor 2002, që tregon se N. (i biri i J. L.) kishte vdekur më 8 tetor 2002;

- Çertifikatën e vdekjes nr.203-1, të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil të Komunës së Suharekës më 18 janar 1982, që tregon se J. L. kishte vdekur më 12 mars 1976;
 - Kontratën e Shitblerjes të lidhur më 31 dhjetor 1958 ndërmjet Sh. G. në cilësinë e shitësit dhe M. L.(babai i J. L.) në cilësinë e blerësit të pronës së kërkuar. Kontrata ishte legalizuar në Gjykatën e Qarkut të Suharekës me numër OV No 331/58;
4. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e njoftoi pronën e kërkuar më 1 korrik 2010 duke e publikuar kërkesën në Gazetën e Njoftimit nr.3 të AKP-së dhe në Buletinin e Zyrës së Pronave të UNHCR-it. Gazeta dhe Lista u lanë te prijësi i fshatit, i cili pranoi që t'ua vë në dispozicion palëve të interesuara, si dhe në hyrje dhe dalje të fshatit Mohlan. Të njëjtat botime u botuan në Rajonin e Komunës dhe të Gjykatës Komunale, Zyrën Kadastrale të Prizrenit, UNHCR, CPRK, EULEX, Ombudspersoni dhe ICO.
 5. Brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, në përputhje me nenin 10.2 të Ligjit nr.03/L-079, asnjë palë nuk ka shprehur interes që të merr pjesë në procedurë përkitazi me pronën që është objekt i kërkesës; prandaj, kërkesa u konsiderua si jo e kontestuar.
 6. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e verifikoi negativisht Kontratën e Blerjes OV Nr.331/58 të datës 31 dhjetor 1958 e cila shërben si bazë ligjore për transferimin e pronës së kërkuar në emër të familjes J.
 7. Sa i përket pronës së kërkuar, nuk është gjetur as në Komunën Kadastrale të Suharekës as në Kadastrin e Zhvendosur në Kruševac. Zyrtarët nga të dy institucionet kompetente konfirmuan se Fleta Poseduese nr.81 është shumë e vjetër dhe numri i ngastrës kadastrale nga periudha 1961 nuk është e njëjta sikur sot.
 8. Në vend të Fletës Poseduese nr.81 e cila është dorëzuar nga pala ankuese, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së *ex officio* ka gjetur Fletën Poseduese nr.104 që e liston ngastrën kadastrale nr.1091 dhe ngastrën kadastrale nr.1092 në emër të J. L.
 9. Pala ankuese është informuar nga Sekretaria Ekzekutive për gjetjet përkitazi me pronën e kërkuar. Ai pranoi se në vitet 1970 janë bërë disa ndryshime lidhur me numrat e ngastrave kadastrale për të cilat ai, megjithatë, pretendon se nuk posedon ndonjë dokument që e shpjegon historikun kronologjik të ndryshimeve.
 10. Palës ankuese i është dorëzuar një letër informuese ku i kërkohet që ai të dorëzojë dokumente shtesë për ta mbështetur kërkesën e tij dhe ai u informua se nëse nuk arrin që t'i dorëzojë dokumentet e kërkuara, Komisioni mund ta refuzojë kërkesën.

11. Letra u pranua nga pala ankuese më 8 prill 2014 (shih faqe 171 të shkresave të lëndës) por ai nuk është përgjigjur.
12. Më 18 qershor 2014, Komisioni me Vendimin e tij KPCC/D/A/244/2014 e refuzoi kërkesën me arsyetimin se Paraqitësi i Kërkesës/Pala Ankuese nuk ka arritur ta dëshmojë pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar menjëherë para apo gjatë konfliktit të viteve 1998-1999.
13. Vendimi i KKKPK-së iu dorëzua palës ankuese më 9 mars 2015. Ai paraqiti ankesë më 3 prill 2015.

Pretendimet e palës ankuese

14. Pala ankuese e kundërshtoi Vendimin e KKKPK-së mbi bazën se vendimi përfshin vërtetim të mangët të fakteve dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
15. Pala ankuese deklaroi se Vendimi i KKKPK-së nuk saktëson qartazi nëse kërkesa hidhet poshtë apo refuzohet. Për më tepër, ai pretendon se nuk është e vërtetë se ai nuk ka paraqitur dokumente shtesë për ta dëshmuar të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar, pasi që ai ka propozuar emrat e tre dëshmitarëve për t'u dëgjuar.
16. Drejt fundit të ankesës së tij, pala ankuese jep një prezantim të hollësishëm të dokumenteve që ai i ka dorëzuar me qëllim të vërtetimit të pronësisë së tij.
17. Në fund, pala ankuese kërkon që Gjykata Supreme ta vërtetojë të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar në dobi të palës ankuese.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

18. Ankesa është paraqitur brenda afatit kohor prej 30 ditësh sikurse parashihet me Ligjin nr. 03/L-079, nenin 12.1, dhe është e pranueshme.

Meritat e ankesës

19. Megjithatë, ankesa është e pabazuar.
20. Në përputhje me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga KKPK-ja për ri-posedimin e pronës, nëse paraqitësi i kërkesës e “dëshmon” të drejtën e tij të pronësisë apo të drejtën për shfrytëzimin e pronës private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, dhe po ashtu dëshmon se ai/ajo nuk është në gjendje t'i ushtrojë këto të drejta për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
21. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka bërë verifikim negativ të Kontratës së Shitblerjes OV Nr.331/58, të dorëzuar nga pala ankuese si dhe të Fletës Poseduese nr.81 të lëshuar më 14 nëntor 1961.
22. Pala ankuese nuk paraqiti prova shtesë që dëshmojnë të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar pavarësisht se kjo ishte kërkuar nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së.
23. KKPK-ja e bazon Vendimin e saj për ta refuzuar kërkesën e palës ankuese në faktin se ai nuk arriti të ofrojë ndonjë provë që do të mund të verifikohet nga AKP-ja se gjyshi i tij, si bartës i të drejtës pronësore, gëzon ndonjë të drejtë pronësie mbi pronën, si dhe në faktin se Sekretaria Ekzekutive nuk siguroi prova të tilla *ex officio*.
24. Ankesa e palës ankuese i përsërit të njëjtat pretendime sikurse janë deklaruar para KKPK-së. Nuk janë paraqitur prova të reja me ankesë, përveç propozimit të tij drejtuar Gjykatës Supreme që ta caktojë një seancë për dëgjimin e tre dëshmitarëve të propozuar nga ai.
25. Gjykata konsideron se seanca dëgjimore e propozuar nga pala ankuese nuk është e domosdoshme për shkak se faktet, rrethanat, dhe pretendimet e tij janë të mjaftueshme për të shërbyer si bazë me qëllim të marrjes së një vendimi meritator.
26. Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja ka marrë vendim korrekt dhe të bazuar gjatë procedurës së mirëfilltë. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstaton se nuk ka pasur shkelje të drejtave materiale apo vërtetim të mangët të gjendjes faktike.
27. Në bazë të lartcekurave, në përputhje me nenin 13.3 nën-paragrafin (c) të Ligjit nr. 03/L-079, është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky Aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Ragip Namani, Gjyqtar

Timo Eljas Torkko, Referent i EULEX-it